

**KONTRATË
TRANSFERIMI KUOTASH
(DHURIM)**

Sot më datë **31.10.2016** në Tiranë nënshkruhet kjo kontratë transferimi për dhurim kuotash :

PALET KONTRAKTUESE :

Pala DHURUESE

Z. Ervin Qendro, lindur në Tepelenë, më 15.02.1979, identifikuar me ID H90215087C, banues në Tiranë, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, që më poshtë në këtë kontratë do të referohet si palë dhuruese.

Pala PRANUESE

Z. Gramoz Qendro, lindur në Tepelenë, më 18.06.1970, identifikuar me ID H00618128S, banues në Tiranë, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, që më poshtë në këtë kontratë do të referohet si palë përfituese,

të cilët shprehën vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë për të përpiluar dhe nënshkruar kontratën e transferimit të kuotave të kapitalit themeltar, si më poshtë :

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Pala dhuruese është ortak i vetëm i shoqërisë "ERAL CONSTRUCTION COMPANY" Shpk e regjistruar në QKB (QKR) dhe organet tatimore me NIPT K 82230002 K me ortak si më poshtë :

- **Ervin Qendro** zotërues 100 % i kuotave të kapitalit, me një vlerë kapitali gjithsej prej 29.445.175,00 lekë. Vlera nominale e një kuote është 294.451,75 lekë.

OBJEKTI I KONTRATËS

Pala dhuruese, **Ervin Qendro**, i dhuron me vullnet të lirë palës pranuese 50 % të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë e barabartë me vlerën 14.722.587,50 lekë, që zotëron në shoqërinë "ERAL CONSTRUCTION COMPANY" shpk.



Pala pranuese, **Gramoz Qendro** me vullnet të lirë dhe të plotë i pranon palës dhuruese **Ervin Qendro** 50 % të kapitalit themeltar, e barabartë me 50 kuota dhe me një vlerë gjithsej 14.722.587,50 lekë.

TRANSFERIMI I PRONËSISË

Me nënshkrimin e kontratës së transferimit (dhurimit) të kuotave të cituara më lart pala dhuruese zhvishet nga 50 % te kapitalit barartë me 50 kuota, me një vlerë të kapitalit prej 14.722.587,50 lekë që gëzon në shoqëri, dhe pala pranuese bëhet zotëruese e pjesës së dhuruar prej 50 % të kapitalit baraz me 50 kuota me një vlerë të kapitalit prej 14.722.587,50 lekë.

Pas nënshkrimit të kësaj kontrate ortakë të shoqërisë "ERAL CONSTRUCTION COMPANY" shpk janë :

1).**Ervin Qendro** - zotërues i 50 % të kapitalit të shoqërisë, ose 50 kuotave me një vlerë të kapitalit prej 14.722.587,50 lekë.

2).**Gramoz Qendro** - zotërues i 50 % të kapitalit të shoqërisë, ose 50 kuotave me një vlerë të kapitalit prej 14.722.587,50 lekë.

Vlera nominale e një kuote pas këtij veprimi nuk ndryshon, ajo mbetet 294.451,75 lekë.

Pala pranuese merr përsipër të gjitha të drejtat e detyrimit e shoqërisë sipas përqindjes së kuotave e kapitalit që gëzon në shoqëri që nga momenti i nënshkrimit të kontratës së dhurimit e në vijim.

Pala pranuese nuk ka asnjë përgjegjësi për detyrimet qe pala dhuruese mund të ketë jashtë shoqërisë.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Kontrata u përpilua në katër kopje me fuqi të barabartë, njëra prej të cilave depozitohet në regjistrin tregtar duke u bërë shënimet për ndryshimet përkatëse.

PALËT KONTRAKTUESE

PALA DHURUESE
Ervin Qendro



PALA PRANUESE
Gramoz Qendro

